

30. 08 2017

P. nr. 204/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, sipas gjyqtarit Ibrahim Idrizi dhe Zyrtare ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR], i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II. nr. 454-2/16, të dt. 18.01.2017, për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë, në bazë të nenit 495 të KPPK-së, me dt. 21.02.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr. 454-2/16, të dt. 18.01.2017, dhe Gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR] në Fsh. [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, me vendbanim të njëjtë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 23.03.2016, rreth orës 12:40, në pyllin publik, në vendin e quajtur “Proni i Vogël”, në rajonin Ekonomiko Pyjor Neredime- Jezercë, është takuar duke prerë 1 copë trungu të ahut të njomë, me diametër 65 cm, e me vëllim të përgjithshëm prej 3.63 m3, e në vlerë prej 490.05€- drunjte kanë qenë të prerë me sharrë motorike dhe të transportuara me kali zhag.

Nga provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: fletëparaqitja e rojës që pyllit me numër 14/2016 i dt. 14.04.2016, procesverbali i komisionit të ekspertëve për vlerësimin e dëmit me nr.110/2016 të datës 14.04.2016, Gjykata vërtetoi se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj Gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimin të paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës bazohet në nenin 450 e 453 të KPPK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike bazohet në nenin 463 par. 2 të KPPK-së.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P. nr. 204/17

Më datë 21.02.2017

Zyrtare ligjore

Arbelinda Tahiri

Gjyqtari,

Ibrahim Idrizi



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj Gjykate përmes kësaj Gjykate. Në rast të vendosjes lidhur me kundërshtimin, Gjykata nuk detyrohet të veprojë sipas kërkesës së prokurorit për dënim me gjobë dhe as me ndalesën nga neni 395 i KPPK-së, që ka të bëjë me parimin “reformatio in peius- mos keqësimi i pozitës së të pandehurit në procedurë”.